

20251423151

Në bazë të nenit 19 paragrafit (4) të Ligjit për Arsimin Fillor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19, 229/20, 3/25 dhe 74/25), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

**RREGULLORE PËR MËNYRËN E KËRKIMIT TË ASISTENTIT ARSIMOR,
MËNYRËN E PËRZGJEDHJES DHE ZGJEDHJES SË ASISTENTIT ARSIMOR, SI
DHE PROGRAMIN E TRAJNIMIT TË ASISTENTIT ARSIMOR**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e kërkimit të asistentit arsimor, mënyra e përzgjedhjes dhe zgjedhjes së asistentit arsimor, si dhe programi i trajnimit të asistentit arsimor.

Neni 2

Nga shkolla fillore komunale, kërkesa për sigurimin e asistentit arsimor dorëzohet deri te shkolla fillore me qendër burimore, sipas rajonalizimit të përcaktuar më parë.

Shkolla fillore komunale, krkesën nga paragrafi 1 i këtij neni, për nxënësit nga klasa e dytë deri në të nëntën, e dorëzon më së voni deri në fund të muajit mars, ndërsa për nxënësit të cilët janë të regjistruar në klasën e parë deri më 15 qershor të vitit shkollor vijues, për vitin shkollor pasardhës.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtrohet në formular, i cili është dhënë në Shtojcën nr. 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni, parastrohet për nxënësit të cilët sipas vlersimit të vështirësisë nga sistemi i vlerësimit për persona me vështirësi kanë vlerësim për nevojën e asistentit arsimor.

Kërkesa nga paragrafi 1 të këtij neni, mund të dorëzohet edhe gjatë vitit shkollor, nëse nxënësi është transferuar nga një shkollë fillore në një shkollë tjetër fillore ose nëse vlerësimi i vështirësisë nga sistemi i vlerësimit për persona me vështirësi është lëshuar pas periudhës nga paragrafi 2 të këtij neni.

Neni 3

Përzgjedhja fillon me kontroll administrativ të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati për asistent arsimor (në tekstin e mëtejme: kontroll administrativ).

Përzgjedhja e kandidatëve për të cilët kontrolli administrativ është përcaktuar se kanë dorëzuar dokumentacion të rregulltë, kryhet në bazë të pikëzimit kumulativ mbi bazat e mëposhtme:

- arritjet e suksesit mesatar në arsim,
- rezultatet e intervistës së realizuar dhe
- certifikatat e fituara lidhur me fushën e cila është përkatëse për vendin e punës.

Në rast se gjatë përzgjedhjes së kandidatit tërhiqet vullnetarisht nga zbatimi i mëtejshëm i saj, Komisioni për Përzgjedhjen dhe Zgjedhjen e Asistentit Arsimor (në tekstin e mëtejme: Komisioni) do t'ia kthejë dokumentacionin nga paragrafi 1 të këtij neni dhe për këtë kandidat nuk bëhet pikëzim.

Neni 4

Gjatë realizimit të përzgjedhjes, përveç kontrollit administrativ, nga Komisioni, do të bëhet pikëzimi i rezultateve të arritura për secilin person që ka aplikuar në thirrjen publike.

Neni 5

Gjatë realizimit të kontrollit administrativ, do të bëhet përcaktimi i dokumentacionit në kohë dhe të plotësuar të paraqitur, si dhe përmbushja e kushteve të specifikuara në thirrjen publike (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i regulltë).

Neni 6

Intervista si pjesë e përzgjedhjes realizohet vetëm në lidhje me ata kandidatë për të cilët gjatë kontrollit administrativ është përcaktuar dokumentacioni i regulltë.

Intervista realizohet me secilin person individualisht, nga Komisioni.

Pas kryerjes së intervistës, nga Komisioni do të përcaktohen rezultatet e arritura për secilin person individualisht.

Neni 7

Pikëzimi nga neni 4 i kësaj rregullore, kryhet në mënyrën në vazhdim:

A) nota mesatare për suksesin në arsim, deri në 30 pikë, edhe atë:

- me sukses mesatar nga 6.00 deri në 7.99 merr 10 pikë,
- me sukses mesatar nga 8.00 deri në 8.99 merr 20 pikë,
- me sukses mesatar nga 9.00 deri në 10.00 merr 30 pikë.

B) rezultatet e intervistës nga 30 deri në 60 pikë.

C) certifikatat e fituara lidhur me fushën e cila është relevante për vendin e punës nga një deri në 10 pikë.

Pikëzimi nga intervista kryhet në bazë të zgjidhjes me gojë të situatave specifike nga puna e drejtpërdrejtë me nxënës me nevoja të veçanta arsimore, nga katër fushat e mëposhtme:

- mbështetje e drejtpërdrejtë për nxënësit me vështirësi;
- bashkëpunim me prindërit/kujdestarët;
- bashkëpunim me mësimdhënësit dhe
- bashkëpunim me bashkëpunëtorët profesionalë nga shkolla fillore dhe bashkëpunëtorët profesionalë nga shkolla fillore me qendër burimore

Neni 8

Nënprogrami për trajnim të asistentit arsimor është dhënë në Shtojcën nr. 2, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 9

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme pas ditës së publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 18-10017/1
14.7.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
проф. д-р **Весна Јаневска**, с.р.

Shtojca nr. 1

KËRKESË PËR SIGURIMIN E ASISTENTIT ARSIMOR

Nga Shkolla Fillore Komunale: _____

Nga Shkolla Fillore me Qendër Burimore: _____

Konform vlerësimit të marrë për sigurimin e mbështetjes nga asistenti arsimor nga sistemi i vlerësimit të personave me vështirësi, me kërkesë të prindit, kërkojmë që të sigurohet asistent arsimor në vitin shkollor 20--/20--, për nxënësit e mëposhtëm:

Numër rendor	Emri dhe mbiemri i nxënësit/es	Klasa	Numri arkivor i vlerësimit nga sistemi i vlerësimit të personave me vështirësi

Në shtojcë Ju dorëzojmë vlerësimin e vështirësisë nga sistemi i vlerësimit i personave me vështirësi për secilin nxënëse/se.

Data dhe vendi:

V.V.

Drejtor,

PROGRAM TRAJNIMI PËR ASISTENT ARSIMOR

Trajnimet e asistentëve arsimorë në shkollat e fillore janë nga fushat, nënfushat dhe temat e trajnimit në vazhdim:

I. Mbështetje direkte për nxënësit me vështirësi

1. Mbështetje në aktivitetet dhe detyrat shkollore

1.1. Aktet ligjore nga fusha e arsimit inkluziv, si ligjet, strategjitë, konceptet, etj.

1.2. Definimi, parimet dhe qasjet e arsimit inkluziv.

1.3. Llojet e vështirësisë dhe kuptimi i tyre (disleksi, disgrafi, diskalkuli, ADHD, çrregullime të zhvillimit që përfshijnë spektrin autik, aftësi intelektuale të kufizuara, vështirësia fizike)

1.4. Strategji dhe metoda për mbështetjen dhe zhvillimin e funksionaliteteve (emocionet dhe marrëdhëniet shoqërore, kujtesa, vëmendja dhe përqendrimi, perceptimi, aftësitë motorike) dhe shembuj të materialeve dhe burimeve,

1.5. Sistemet dhe personalitetet - të menduarit sistematik dhe qasje e dyfishtë në punën me mikrosistemet (familja dhe paralelja),

1.6. Ndërgjegjësimi për situatat e mësimi – ndikimi i faktorëve kontekstualë në prani, pjesëmarrje dhe arritjet e nxënësit.

1.7. Qasjet dhe metodat në punën me nxënës me lloje të ndryshme të vështirësisë në procesin edukativo-arsimor,

1.8. Përshtatja e përmbajtjes, hapësirës, kohës, materialeve/burimeve dhe aktiviteteve, sipas aftësive dhe nevojave individuale të nxënësve me vështirësi

1.9. Puna në çifte mësimdhënës - asistent arsimor gjatë zbatimit të orës (mësimdhënie tandem),

1.10. Njohuritë digjitale dhe aftësitë digjitale në realizimin e arsimit gjithëpërfshirës,

1.11. Mbështetje vizuale në mësimdhënie (komunikim augmentativ dhe alternativ, teknologji ndihmëse, strategji sensorike (shqisore) në klasë),

1.12. Hyrje në qasjet specifike për punën me fëmijët me vështirësi (Montesori, Tiç ABA, terapi shqisore, terapi figurative , terapi muzikore, terapi okupacionale, terapi loje, etj.),

1.13. Menaxhimi i kohës së orës - qasje dhe mënyra për të ruajtur vëmendjen, fokusin dhe përqendrimin në detyrat e punës, si dhe kalimin nga një aktivitet në tjetrin,

1.14. Trajnim në gjuhën e shenjave dhe në alfabetin e Brajlit ,

1.15. Të folurit - stimulim, ushtrime për të inkurajuar dhe zhvilluar të folurit.

2. Mbështetje në komunikim, bashkëveprim shoqëror dhe përfshirje

- 2.1. Mbështetje nga bashkëmoshatarët, duke inkurajuar bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e nxënësve me vështirësi me nxënës të tjerë, në aktivitete mësimore dhe jashtëshkollore,
- 2.2. Aftësi sociale për pranimin dhe respektimin e diversitetit, tolerancën dhe sjelljen jo të dhunshme,
- 2.3. Strategji për komunikim efektiv me nxënësit për të ofruar mbështetje dhe besim,
- 2.4. Aftësi për menaxhimin e situatave socio-emocionale - njohja e nevojave dhe emocioneve të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe trajtimi i tyre,
- 2.5. Zhvillimi i aftësive të asistentëve arsimorë për trajtimin e sjelljes agresive të nxënësit me nevoja të veçanta arsimore dhe mbrojtjen e një fëmije viktimë (bullizim),
- 2.6. Zhvillimi emocional i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore - trajtimi i zemërimit, tërbimit, agresionit dhe përgjigjeve emocionale të papërshtatshme.
3. Ndhmë me lëvizjen, përdorimin e mjeteve ndihmëse, orientimin në ambiente
- 3.1. Njohuri elementare për zhvillimin e funksioneve psikomotorike dhe
- 3.2. Regullat elementare për sigurimin e lëvizjes në haprisë
4. Ndhmë me kujdesin ndaj vetes
- 4.1. Edukimi dhe mbështetja e nxënësve mbi ushqyerjen dhe higjienën personale.
- II. Bashkëpunimi me prindërit/kujdestarët
1. Bashkëpunimi me prindërit e nxënësve me vështirësi
- 1.1. Bashkëpunim me prindërit e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe komunitetin,
- 1.2. Komunikim efektiv me prindërit/kujdestarët e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore për të ndihmuar dhe mbështetur të nxënë e nxënësit, dhe
- 1.3. Plani i mbështetjes për fëmijën dhe familjen.
2. Bashkëpunimi me prindërit e nxënësve me zhvillim tipik në klasë dhe shkollë për të thyer barrierat, stereotipet dhe paragjykimet.
- III. Bashkëpunim me mësimdhënësit
- Përshtatja e mësimdhënies sipas karakteristikave të nxënësve, strategjive të të nxënëit dhe mësimdhënies
- 1.1 Plan individual arsimor (njohuri bazë),
- 1.2 Program i modifikuar (njohuri bazë),
- 1.3 Mbështetje e nxënësit me vështirësi në shkrimin fillestar - zhvillimi i aftësive grafomotorike, teknikave të shkrimit, etj.,

1.4 Monitorimi i arritjeve të nxënësve dhe ofrimi i mbështetjes adekuate për progresin dhe

1.5 Përmirësimi i klimës socio-emocionale në klasë.

IV. Bashkëpunimi me bashkëpunëtorët profesionalë dhe ekipin gjithëpërfshirës të nxënësve

1. Shkëmbimi i njohurive dhe informacioneve

1.1. Planifikimi i punës personale dhe mbajtja e evidencës së punës,

1.2. Bashkëpunimi si faktor i rëndësishëm në procesin e gjithëpërfshirjes,

1.3. Mbështetja e mësimeve në planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e procesit edukativo-arsimor të nxënësve me vështirësi dhe

1.4. Mbështetja për nxënësin në mësim në dhomë sensorike (shqisore)